

# INTEGRITET LLOGARIDHËNIE PARTNERITET

## NË FOKUS

- *Pavarësia e performancës së Policisë së Shtetit nga ndikimi politik – dakordësimi i mekanizmit të kontrollit dhe balancës për emërimin/shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*
- *Miratimi me ligj i statusit të punonjësit të Policisë së Shtetit në të tre komponentët e tij: siguria e punonjësve të policisë për shkak të detyrës, statusi ekonomik në të gjithë përbërësit e tij, dhe njehsimi i gradës policore me atë të statusit të administratës publike.*
- *Fuqizimi i komisarariatit vendor me kompetenca, burime njerëzore dhe financiare.*
- *Hartimi dhe zbatimi i Planit të Integritetit për çdo njësi policore si instrument i ndryshimit të kulturës së menaxhimit dhe luftës kundër korrupsionit.*



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

BULETIN Nr. 9  
**Integritet**  
**Llogaridhënie**  
**Partneritet**

Janar 2021

**Stafi i IDM dhe bashkëpunëtorët e projektit:**

Rovena Sulstarova, Menaxhere Projekti

Besjana Kuçi, Konsulente e Komunikimit

Anxhela Bruçi, Asistente Projekti

Sotiraq Hroni, Konsulent i Lartë

Për më shumë informacion si dhe për dërgesë të opinionëve mund të na kontaktoni në adresën e email: [info@idmalbania.org](mailto:info@idmalbania.org) ose tel: 042400241

**Shënim:**

*Ky buletin u realizua në kuadër të Projektit: "Ndërtimi i Integritetit për përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmëria e luftës kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri" i cili mbështetet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta (Holandës). Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht ato të qeverisë holandeze.*

LANÇIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT  
TË KOMISARIATIT NR.1, TIRANË 4

STUDIMI MBI INTEGRITETIN DHE  
KORRUPSIONIN POLICOR NË  
SHQIPËRI 6

KUSHTET E PUNËS DHE  
TOLERANCA NDAJ KORRUPSIONIT  
MES PUNONJËSVE TË POLICISË  
NË SHQIPËRI | DOKUMENT  
POLITIKASH 8

INFOGRAFIKËT PER INTEGRITETIN  
DHE KORRUPSIONIN POLICOR 9

REKOMANDIME NGA PLANI I  
VEPRIMIT (BLUEPRINT) PËR  
FORCIMIN E INTEGRITETIT DHE  
LLOGARIDHËNIES NË POLICINË E  
SHTETIT 14

# KY NUMËR PËRMBAN

Një përmbledhje nga konferenca e lancimit të Planit të Integritetit të Komisarariatit nr.1, një dokument i hartuar në bashkëpunim me punonjësit e Komisarariatit. Plani i Integritetit (PI) në Komisariatin Nr. 1 synon ngritjen e mekanizmave institucionalë anti-korrupsion dhe zbatimin e masave konkrete të cilat pritet të eliminojnë apo zvogëlojnë risqet e integritetit, veprimeve jo-etike apo jo-profesionale në institucion.

Një përmbledhje të studimit kombëtar për integritetin dhe korrupsionin në policinë e Shtetit duke e konkretizuar me gjetjet e studimit si dhe rekomandimet e plan veprimit (Blueprint-it) për forcimin e integritetit dhe llogaridhënies në Policinë e Shtetit.

Gjithashtu, në këtë numër do të paraqesim edhe një përmbledhje të gjetjeve kryesore të studimit për perceptimin publik dhe atij të punonjësve të policisë për etikën dhe integritetin policor të kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) për herë të tretë (2014–2016-2020). Gjetjet e këtij studimi janë ilustruar edhe nëpërmjet infografikëve duke bërë krahasime të këtyre perceptimeve ndër vite.



# LANÇIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT TË KOMISARIATIT NR.1, TIRANË

Komisariati i Policisë Nr. 1 në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë është struktura e parë policore që harton një Plan Integriteti, si një mekanizëm anti-korrupsion për të adresuar risqet e integritetit të vlerësuara në institucion. Ky Plan Integriteti ka një periudhë zbatimi 2020–2023. Dokumenti iu prezantua të gjithë aktorëve të interesit, në një konferencë lançuese në tetor 2020. Në këtë buletin paraqiten disa nga fjalimet e aktorëve kyç të këtij procesi, që u mbajtën gjatë aktivitetit lançues të Planit të Integritetit për komisaratin nr.1 Tiranë.



**Znj. Guusje Korthals Altes, Ambasadorja e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri,** theksoi gjatë aktivitetit lançues se, projekti që po zbaton IDM ishte projekt i parë me të cilin u njoh me ardhjen e saj në Shqipëri. Ambasadorja vuri në dukje se besimi në institucionet publike dhe në sundimin e ligjit janë thelbësore për një demokraci të shëndetshme dhe për prosperitet. Ajo shtoi se policia promovon sigurinë për qytetarët dhe qëllimi i saj është të veprojë në interesin e mirë të shoqërisë. Për ta arritur këtë, policia ka nevojë për mbështetje nga komuniteti. Për të marrë këtë mbështetje, besimi është elementi kryesor për ta fituar atë. Përgjegjshmëria, transparenca dhe integriteti janë fjalët kyçe. Në ilustrim të konceptit të llogaridhënies, Ambasadorja solli shembullin e takimeve të “trekëndëshit” ku pushteti vendor, policia dhe prokuroria takohen së bashku me qytetarët për të shkëmbyer informacion mbi përparësinë në luftën kundër krimit. Ajo theksoi se asnjë vend nuk është imun ndaj korrupsionit dhe kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që mekanizmat të zbatohen për të luftuar korrupsionin. Në

përmbyllje të fjalës së saj, Ambasadorja theksoi se forcimi i integritetit në polici është thelbësor për integrimin evropian të Shqipërisë.

**Znj. Adea Pirdeni, Zv. Ministre e Drejtësisë dhe Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit,** e konsideroi lancimin e Planit të Integritetit të Komisarimit Nr. 1 si tejet të rëndësishëm. Kjo pasi, Plani i Integritetit është një çështje jetike jo vetëm për mirëfunksionimin e shëndetshëm të atij Komisarimit, por për të gjithë institucionet ligjzbatuese. Znj. Pirdeni theksoi se Ministria e Drejtësisë koordinon një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirës në forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit, në bazë të Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit dhe Planit Përkates të Veprimit 2020-2023. Zv. Ministria shtoi se Plani i Veprimit në zbatim të kësaj strategjie, i miratuar nga qeveria shqiptare, përfaqëson një dokument të hartuar në përputhje me të gjithë standardet për hartimin e dokumenteve strategjike. Plani i Veprimit bazohet në një qasje të trefishtë për adresimin e problematikave të lidhura

me korrupsionin, konkretisht: qasjen parandaluese, qasjen ndëshkuese dhe qasjen ndërgjegjësuere. Në lidhje me procesin e hartimit dhe miratimit të një plani integriteti për një njësi policore, zv. Ministria e çmoi si një proces shumë të rëndësishëm për institucionin pasi fokusi do të ishte tek qasja parandaluese dhe fuqizimi i mekanizmave parandalues për vlerësimin e riskut të integritetit dhe sjelljeve të mundshme korruptive. Znj. Pirdeni theksoi se uniforma dhe distinktivët që mbajnë oficerët e Policisë së Shtetit janë një simbol besimi, që e vesh gjithnjë publikun me pritshmërinë e drejtë se një oficer policie duhet të ruajë integritetin, të shmangë çdo rast konflikti interesi, si dhe të sillet dhe të angazhohet maksimalisht në evidentimin dhe kapjen e personave që kryejnë vepra penale. Ajo shtoi se është detyrë personale e çdo oficeri policie të sillet me integritet, jo vetëm si një shprehje e qëndrimit të tij profesional dhe etik, por si një detyrim ndaj forcave të Policisë së Shtetit. Zv. Ministria solli në vëmendje se Plani i Integritetit do të kontribuojë në formimin e një kulture administrative të brendshme në Komisarjat, pro integritet, mos-pranuese dhe parandaluese të korrupsionit nga të gjithë punonjësit, përfshirë këtu nivelin drejtues dhe zbatues. Në përfundim të fjalës së saj, Znj. Pirdeni theksoi se Ministria e Drejtësisë do të ofrojë asistencë të pakursyer në të gjithë strukturat që synojnë të përforcojnë këto mekanizma.

**Z. Gjovalin Loka, Drejtor i Departamentit për Sigurisë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,** theksoi se Policia e Shtetit vlerëson maksimalisht objektivin e projektit i cili është forcimi i integritetit të organizatës së policisë, nëpërmjet krijimit të sistemeve e mekanizmave efektive të integritetit dhe promovimit të praktikave të mira të menaxhimit të tij. Z. Loka nënvizoi se strukturat qendrore dhe vendore të



Policisë së Shtetit kanë përmbushur detyrimet dhe kanë dhënë kontributin e tyre, duke bashkëpunuar me IDM-në për marrjen pjesë në takime të grupeve të punës të ngritura nga secila palë. Drejtori vuri theksin në disa komponentë të projektit, si zhvillimi i takimeve publike llogaridhënëse bashki- polici-prokurori; hartimi i Planit të Integritetit të Komisarjatisë të Policisë nr. 1, Tiranë; realizimi i tryezave për efektivitetin e Kodit të Etikës dhe çështje të tjera të integritetit; përgatitja e kurrikulës së trajnimit dhe trajnimi i trajnerëve mbi etikën dhe integritetin, përmes Akademisë së Sigurisë; kryerja e sondazhit me skenarë për punonjësit e policisë dhe publikun; shpërndarja e Buletineve të përgatitur nga IDM për sensibilizimin e Policisë së Shtetit dhe opinionit publik në lidhje me këto zhvillime. Drejtori theksoi se është i rëndësishëm vijimi i punës së strukturave të policisë përgjegjëse në komisarjatin nr.1 për zbatimin e masave të planifikuara në Planin e Integritetit, respektimin e afateve kohore të parashikuara, si dhe punën për monitorimin nga strukturat eprore gjatë implementimit të këtij plani, me qëllim marrjen e rezultateve të pritshme. Z. Loka theksoi se Policia e Shtetit do të mbështesë në të ardhmen çdo aktor vendas dhe të huaj dhe do bëhet pjesë e çdo projekti që ndihmon në përmbushjen me cilësi të misionit, prioritetëve dhe objektivave që ajo ka.







**Z. Idriz Haxhiaj, Drejtor i Drejtorisë së Strategjive për Sigurinë Publike në Ministrinë e Brendshme,** cilësoi në fjalën e tij se policia e shtetit dhe institucionet e tjera shqiptare kanë marrë një angazhim të mbarë institucional për Planet e Integritetit me qëllim forcimin dhe konsolidimin e veprimtarisë së tyre. Ai shtoi se ajo realizohet me një bashkëpunim të ngushtë me partnerët në përmbushje të rekomandimeve të tyre, ku një ndër rekomandimet ishte dhe Plani i Integritetit i cili realizohet në kuadër të proceseve integruese. Z. Haxhiaj shtoi se gjetjet e

IDM-së kanë mundësuar identifikimin e fushave të mundshme vulnerabël ndaj abuzimeve, keq-trajttimeve apo tejkalimeve të kompetencave. Ai theksoi se janë identifikuar në mënyrë të detajuar, strukturat dhe funksionet si pjesë e Planit të Integritetit për të përmbushur dhe minimizuar këto fenomene.



## STUDIMI MBI INTEGRITETIN DHE KORRUPSIONIN POLICOR NË SHQIPËRI

Ky raport paraqet gjetjet nga sondazhi i perceptimit publik dhe atij të punonjësve të policisë të kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) për herë të tretë (2014–2016–2020). Ky raport synon të mbështesë përpjekjet anti-korrupsion të Policisë së Shtetit përmes:


- Duke matur perceptimin publik të korrupsionit policor dhe identifikimin e faktorëve kryesorë që çojnë në praktika korruptive;
- Duke marrë perceptimin e të anketuarve në radhët mbi korrupsionin dhe faktorët të tilla si faktorë ligjorë, institucionalë apo kulturorë, që mundësojnë korrupsionin në polici;
- Duke vlerësuar situatën në lidhje me korrupsionin dhe nxitësit e korrupsionit në periudha të ndryshme kohe, duke identifikuar fushat ku janë bërë zhvillime ose regres në këtë drejtim.

Nga një krahasim i perceptimit të publikut dhe atij të policisë për korrupsionin në

Policinë e Shtetit evidentohet vazhdimisht një hendek mes asaj që perceptohet nga publiku i gjerë dhe asaj që perceptojnë vetë punonjësit e policisë. Me kalimin e kohës, perceptimi i korrupsionit, i matur nga rezultatet e sondazhit, mund të paraqitet si një kurbë e përmbysur U, ku korrupsioni perceptohet se përkeqësohet gjatë viteve 2014 dhe 2016, por me përmirësim të vogël në studimin e vitit 2020.

Publiku i gjerë konfirmoi se për ta ishte më se e zakonshme të dëgjonin në lidhje me korrupsionin në Policinë e Shtetit. Nga të anketuarit, 86.7% konfirmuan se në 12 muajt e fundit kishin dëgjuar për korrupsionin në polici. Ndonëse publiku deklaronte se kishin dëgjuar shpesh për korrupsionin në polici, të anketuarit nga radhët e policisë raportonin se kishin dëgjuar rrallë për të. Për më tepër, përqindja e të anketuarve nga publiku që pohonin se në Policinë e Shtetit ka korrupsion ishte 89%. Si për krahasim, studimi evidenton se perceptimi i policisë për korrupsionin është thjesht i moderuar.

Po ashtu, publiku e konsideron korrupsionin si pjesë të sistemit dhe



# Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri 3.0

të përhapur në të gjitha strukturat dhe radhët e Policisë së Shtetit. Perceptimi i të anketuarve të policisë mbi seriozitetin dhe përhapjen e korrupsionit ofron një pamje krejt tjetër, ku pjesa më e madhe e konsideron korrupsionin të shfaqur në raste të izoluar.

Të dy sondazhet ofrojnë informacione më të hollësishme për tipologjinë e korrupsionit në polici. Publiku i gjerë e konsideron korrupsionin përgjithësisht më të përhapur në nivelet e larta të policisë, sesa te punonjësit e nivelit të ulët dhe të mesëm. Shumica e të anketuarve nga policia raportuan se atyre nuk u është ofruar kurrë ryshfet dhe as nuk u është dhënë asnjë favor jo-monetar nga qytetarët. Një përqindje edhe më e lartë e punonjësve të policisë raportuan se nuk kanë qenë kurrë dëshmitarë të një sjelljeje të tillë. Ky konstatim në fakt bie në kundërshtim me sondazhin publik, në të cilin më shumë se 60% e të anketuarve thanë se ryshfeti dhe favorizimet janë forma korrupsioni që ndodhin ‘shpesh’ ose ‘shumë shpesh’ në polici. Po ashtu, punonjësit e policisë duket se e konsiderojnë korrupsionin si sjellje të një individi dhe pjesë të sistemit.

Vetëm 6% e të anketuarve thanë se kanë denoncuar një vepër korrupsioni të një punonjësi të Policisë së Shtetit. Me sa duket qytetarët ngurrojnë të denoncojnë

korrupsionin dhe zgjedhin t’i zgjidhin nëpërmjet ryshfetit problemet që kanë. Edhe mungesa e informacionit se ku mund të denoncojnë korrupsionin ose ideja se denoncimi i korrupsionit ha shumë kohë renditen si arsye për të mos denoncuar rastet e korrupsionit. Sondazhi publik nxjerr në pah se Komisariati Dixhital dhe numri i gjelbër i SHÇBA janë mjete të rëndësishme që ndihmojnë në denoncimin e korrupsionit, ndërkohë që publiku raporton se praktikat korruptive denoncohen edhe përmes Prokurorisë së Përgjithshme ose në Komisaratin e Policisë.

Gjysma e qytetarëve të anketuar besonin se korrupsioni shfaqet ‘shpesh’ ose ‘shumë shpesh’ në shpërdorimin e fondeve të Policisë së Shtetit. E njëjta përqindje e publikut të gjerë besonte se korrupsioni bën që punonjësit e policisë të manipulojnë provat ose të përdorin dhunën ‘shpesh’ ose ‘shumë shpesh’. E kundërta raportohet në sondazhin e policisë, ku veprat e korrupsionit si ryshfeti, favorizimet, shpërdorimi i fondeve publike, abuzimi me forcën ose manipulimi i provave, shihen si fenomene që nuk ndodhin ‘kurrë’ ose ndodhin ‘rrallë’. Si sondazhi me publikun ashtu edhe ai me policinë nxorën në pah perceptime të ngjashme të ndikimit të rekrutimit dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore të korrupsioni.

Ndër faktorët me më shumë ndikim që çojnë në korrupsion, siç raportohet nga sondazhi me publikun, janë pranimi në përgjithësi i korrupsionit dhe influenca e politikës. Faktorë të tjerë që mendohet se çojnë në korrupsion janë kultura institucionale e Policisë së Shtetit dhe menaxhimi ose profesionalizmi i punonjësve të policisë, por në një shkallë më të vogël. Në sondazhin publik u evidentua një nivel i lartë besimi në aftësinë e policisë për të luftuar korrupsionin brenda radhëve të saj. Ky besim duket është më i madh te popullsia në moshë të re. Sondazhi me policinë

tregoi se duhet të përmirësohet kuadri ligjor për luftën kundër korrupsionit. Besimi në aftësinë për të luftuar korrupsionin në Policinë e Shtetit përforcohet edhe më shumë nga besimi në procesin e vetingut.

## KUSHTET E PUNËS DHE TOLERANCA NDAJ KORRUPSIONIT MES PUNONJËSVE TË POLICISË NË SHQIPËRI

### | DOKUMENT POLITIKASH

Gjatë dy dekadave të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme politike me qëllim forcimin e sistemit të integritetit në polici.

Gjithsesi, procesi i zhvillimit dhe forcimit të integritetit të policisë ka qenë i ngadaltë dhe policia mbetet një nga institucionet më të ekspozuara ndaj praktikave korruptive. Një sistem efektiv i përgjegjshmërisë së policisë nënkupton si masat parandaluese, ashtu edhe ato ndëshkuese. Këto të fundit përdoren shpesh për të luftuar korrupsionin në polici, por me rezultate të kufizuara, sepse shpesh ato nuk arrijnë të shpjegojnë shkaqet themelore që nxisin korrupsionin në polici. Nga ana tjetër, masat parandaluese kanë kontribuar në suksesin e shumë vendeve (të tilla si Gjeorgjia, Singapori dhe Hong Kongu) në luftën

kundër korrupsionit dhe në përmirësimin e kushteve të punës, pagave, programeve të trajnimit dhe rregullave organizative që mundësojnë forcimin e integritetit dhe etikës në polici. Prandaj, ky dokument politikash përqëndrohet në qasjen parandaluese ndaj korrupsionit në polici. Dokumenti ka si synim të shqyrtojë ndikimin që kanë kushtet e punës (paga, përgatitja profesionale dhe trajnimi në vendin e punës, kultura organizative e punës, kodi i etikës dhe rregulloret e brendshme) në perceptimin e punonjësve

të policisë në lidhje me tolerancën ndaj korrupsionit në Shqipëri.

Për këtë qëllim, në këtë dokument kemi përdorur një qasje të kombinuar kërkimore, ku ndërthuren metodat sasore dhe cilësore të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. Informacioni sasior sigurohet nga një studim i perceptimit publik që u administrua me një kampion prej 370 oficerësh policie në Shqipëri në 2016 dhe përsëri me një kampion prej 255 oficerësh policie në vitin 2020. Në burimet e informacionit të metodës kërkimore cilësore bëjnë pjesë 4 intervista gjysmë të strukturuar të kryera gjatë periudhës shkurt-prill 2020 me oficerë policie dhe përfaqësues të sindikatës së policisë.

Studimi konstaton se ekziston një marrëdhënie pozitive ndërmjet perceptimit për kushtet e këqija të punës dhe tendencës për korrupsion. Analiza e korrelacionit tregon se në përgjithësi, ekziston një korrelacion i rëndësishëm statistikor midis të gjitha variablave që matin kushtet e punës së oficerëve të policisë dhe prevalencës së korrupsionit që ata raportojnë se kanë përjetuar. Përsa i përket perceptimeve të oficerëve të policisë, studimi konkludon se midis shumë faktorëve që perceptohen se shkaktojnë predispozicion për korrupsion, pagat e ulëta dhe kodi etik i policisë kanë ndikimin më të lartë, duke vijuar me përgatitjen e dobët profesionale dhe mungesën e trajnimit në punë dhe mungesën e kulturës organizative.

Megjithëse në harkun kohor të 4 viteve, ka një rënie të lehtë të tendencës për të perceptuar faktorët e lartpërmendur si më pak të ngjashëm për të kontribuar në rritjen e tolerancës ndaj korrupsionit (përveç perceptimit mbi rregulloret e brendshme dhe kodin etik të cilat janë rritur pak kohët e fundit), përqindjet janë ende të konsiderueshme edhe për vitin 2020. Kushtet e përshtatshme të punës, në veçanti, perceptohen se janë me rëndësi të madhe për oficerët e policisë për të kryer në mënyrë efektive detyrat e ngarkuara. Edhe niveli i kënaqësisë me mjedisin e




punës është tregues i rëndësishëm për të evidentuar nëse punonjësit e policisë janë të përkushtuar ndaj standardeve të larta profesionale. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi synojnë të informojnë dhe kontribuojnë në hartimin e masave efektive

kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri.

Lexoni dokumentin e plotë në [www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org).



## INFOGRAFIKËT PER INTEGRITETIN DHE KORRUPSIONIN POLICOR



**NDIKIMI I FAKTORËVE KULTURORË, TË SJELLJES, DHE INSTITUCIONALË TE KORRUPSIONI**



Sipas gjykitimit tuaj, sa ndikojnë faktorët e mëposhtëm në përhapjen e korrupsionit në polici?

Ju lutem vlerësoni

1 ASPAK

SHUMË TË FORTË 5

Perceptimi  
i publikut

Perceptimi i punonjësve  
të Policisë së Shtetit





2020



2016

2014



**NDIKIMI I POLITIKËS NË POLICI**



**KULTURA E PUNËS NË INSTITUCIONIN E POLICISË**



**MENAXHIMI I DOBËT I POLICISË**



Përgjithësisht vihet re një trend në rënie të ndikimit të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në nxitjen e korrupsionit në Policinë e Shtetit. Në sondazhin e vitit 2020, punonjësit e policisë, përveç nivelit të pagave, vlerësojnë menaxhimin dhe kulturën e punës në institucionin e policisë si faktorë me shumë ndikim në nxitjen e korrupsionit në Policinë e Shtetit.

## KULTURA E MENAXHIMIT NE POLICINË E SHETITIT



Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

Ju lutem vlerësoni

1 ASPAK

PLOTËSISHT DAKORD 5




Perceptimi  
i publikut

Plotësisht dakord  
Dakord

Neutral  
Kryesisht jo dakord

Aspak dakord

### PERCEPTIMI I PUBLIKUT PËR PRAKTIKAT E REKRUTIMIT, PROMOVIMIT, NDIKIMIT TË DREJTUESVE POLITIKË DHE PROKURIMET NË POLICINË E SHETITIT (NË %, N=1099) (SONDAZHI I VITIT 2020)



Në përgjithësi, publiku nuk është dakord se rekrutimi dhe ngritja në detyrë e punonjësve në Policinë e Shtetit bazohet në meritokraci. 52% e të anketuarve besojnë se rekrutimi nuk është i bazuar në meritokraci, ndërsa, më konkretisht, 56% e të anketuarve janë dakord/plotësisht dakord se emërimi në poste të larta në radhët e Policisë së Shtetit nuk është e bazuar në meritokraci, dhe 52% besojnë se ngritja në detyrë e punonjësve të nivelit bazë dhe të mesëm nuk bazohet në meritokraci. Nga ana tjetër, publiku beson se institucioni i Policisë së Shtetit përdoret nga drejtuesit e tij për qëllime politike; 63% e të anketuarve nuk janë dakord ose aspak dakord me pohimin se "drejtuesit e policisë nuk e përdorin institucionin për përfitime politike".

**KULTURA E MENAXHIMIT NE POLICINE E SHETIT**



Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

Ju lutem vlerësoni

1 ASPAK

PLOTËSISHT DAKORD 5




Perceptimi i punonjësve të Policisë së Shtetit

Plotësisht dakord  
 Dakord

Neutral  
 Kryesisht jo dakord

Aspak dakord

**PERCEPTIMI I POLICISË PËR PRAKTIKAT E REKRUTIMIT, NDIKIMIN E DREJTUESVE POLITIKË DHE PROKURIMET NË POLICINË E SHETIT (NË %, N=253) (SONDAZHI I VITIT 2020)**



Afërsisht gjysma e të anketuarve në sondazhin e policisë nuk ishin dakord se rekrutimi dhe ngritja në detyrë bazohen në meritokraci. Gjithashtu, gjysma e të anketuarave në polici, nuk janë dakord me deklaratën se policia nuk përdoret asnjëherë nga drejtuesit për qëllime politike. Të dhënat e sondazhit me policinë mbështesin më shumë sesa publiku deklaratën se punonjësit e policisë dhe eprorët e tyre bashkëpunojnë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit. Perceptimi i policisë kundrejt publikut ndryshon ndjeshëm kur bëhet fjalë për prokurimet; 51% e punonjësve të anketuar të policisë thanë se ishin dakord/plotësisht dakord që prokurimi në polici kryhej në përputhje me rregulloret, krahasuar me të njëjtën përqindje të publikut që nuk ishin dakord.

## NDIKIMI I FAKTORËVE TË MËPOSHTËM NË PËRHAPJEN E KORRUPSIONIT NË POLICI



Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

Ju lutem vlerësoni

1 ASPAK


SHUMË TË FORTË 5

Perceptimi i publikut dhe ai i policisë për faktorët që nxisin korrupsionin është dukshëm i ndryshëm. **Për publikun, toleranca ndaj korrupsionit nga shoqëria dhe brenda organizatës së policisë ka një ndikim po aq të fortë në nxitjen e këtij fenomeni.** Ndërsa për të anketuarit në polici, ka një vlerësim relativisht të lartë për procedurat e rekrutimit dhe promovimit jo mbi baza meritokracie, si një ndër faktorët që ndikon te korrupsioni.

└ Përqindja e **policisë** që raporton ndikim të fortë/shumë të fortë në nivelin e korrupsionit

└ Përqindja e **publikut** që raporton ndikim të fortë/shumë të fortë në nivelin e korrupsionit

Tolerimi i korrupsionit në polici nga ana e publikut  
si një mënyrë për të mbyllur punët shpejt





# REKOMANDIME NGA PLANI I VEPRIMIT (BLUEPRINT) PËR FORCIMIN E INTEGRITETIT DHE LLOGARIDHËNIES NË POLICINË E SHTETIT

Siç edhe përshkruhet në këtë buletin, sondazhi i vitit 2020 mbi korrupsionin dhe integritetin policor është i treti në radhë pas atij 2014 dhe 2016. Evidencat e prodhuara në vite krijojnë një bazë të dhënash që mbështesin nevojën për reforma të qëndrueshme në Policinë e Shtetit. Këto evidenca diktojnë nevojën për politika të reja në shumë fusha për sektorin e Policisë së Shtetit të tilla si: menaxhimi policor, etika dhe integriteti, emërimet dhe rekrutimet, transparencja dhe komunikimi publik, partneritetet dhe llogaridhënia horizontale, krijimi i një kulture të brendshme për matjen e performancës dhe zbutjen e risqeve të korrupsionit në Policinë e Shtetit. Në këtë kuadër, IDM inicioi një Plan Veprimi (Blueprint) me disa rekomandime konkrete, zgjidhja e të cilave do të adresonte probleme në mbështetje të Policisë së Shtetit drejt vendit të merituar në një shoqëri demokratike.

## PROFESIONALIZIMI I DREJTIMIT TË PSH

Ndikimi i politikës tek Policia e Shtetit përgjatë periudhës 2013 – 2020 perceptohet si faktor me ndikim të fortë ose shumë të fortë në përhapjen e korrupsionit në PSH nga rreth 71% dhe 76% e qytetarëve.<sup>1</sup> Nisur nga kjo gjetje, nevojitet pavarësia e performancës së PSH nga politika. Vendosja e një mekanizmi të ‘balancës dhe kontrollit’ në emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm të PSH do të ndihmonte në pavarësinë e PSH. Një çështje tjetër po aq thelbësore është perceptimi i pjesëtarëve të PSH se avancimi i karrierës së tyre nuk do të varet nga asgjë



1 74% e publikut sipas studimit të 2014, 76% sipas studimit të 2016 dhe 71% në studimin e 2020. Për më shumë informacion shih IDM. 2020. Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri 3.0. Tiranë: IDM, fig.39, f.68. Ndërkohë që për faktorin e parë IDM i ka pyetur të anketuarit në të 3 studimet e tij, “menaxhimi i dobët i PSH” është futur për herë të parë në 2016ën

tjetër veç performancës së tyre dhe një procesi plotësisht të parashikueshëm dhe meritokratik.


Lidhur me emërimin apo shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit mund të procedohet për analogji me praktiken kushtetuese të emërimit dhe shkarkimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë apo Drejtorit të Shërbimit Informativ. Një tjetër alternativë mund të ishte emërimi dhe shkarkimi nga Këshilli i Ministrave me pëlqimin e një strukture përfaqësuese të Kuvendit të Shqipërisë. Në të dyja rastet, përzgjedhja e emrit të Drejtorit të Përgjithshëm do të realizohet përmes një procesi konkurrues dhe transparent, i iniciuar nga një votim i fshehtë i punonjësve me grada “drejtues” dhe “drejtues i parë” të Policisë së Shtetit, ndërsa Ministri i Brendshëm paraqet pranë Këshillit të Ministrave për emërim tre kandidaturat më të votuara.

Një tjetër çështje që ndikon në profesionalizimin e PSH është roli i pagës dhe kushteve të brendshme të punës me korrupsionin. Një iniciativë e cila do të zgjidhte përfundimisht këto probleme është miratimi me ligj i këtij statusi të punonjësit të policisë së shtetit në të tre komponentët e tij: siguria e punonjësve të policisë për shkak të detyrës, statusi ekonomik në të gjithë përbërësit e tij, dhe njehsimi i gradës policore me atë të statusit të administratës publike.

## PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT POLICOR

Kultura e punës në institucionin e PSH”





dhe “Menaxhimi i dobët i PSH” shihen si faktorë rrisht në përhapjen e korrupsionit në Polici jo vetëm nga publiku, por edhe nga ana e punonjësve të PSH. Ndonëse problematikat lidhur me shpërdorimin e fondeve apo të mjeteve të policisë konfirmohen thuhet nga një në çdo tre ose katër punonjës të policisë të anketuar në të tre studimet, sfidat e menaxhimit policor shihen po ashtu edhe në mënyrën e organizimit të strukturave policore në nivel drejtorish rajonale dhe nivel qendror, po aq sa edhe në proceset problematike të menaxhimit të karrierës të tilla si emërimet apo promovimet në detyrë në struktura policore.

Ka një nevojë të qartë për forcimin e komisarariatit vendor, si me kompetenca ashtu edhe me objektiva konkrete pune, burime njerëzore dhe financiare. Këtu duhet menduar edhe dinamika e komisariateve me Drejtoritë e Policisë së Qarqeve. Një ide që është paraqitur më herët nga vetë struktura të brendshme të PSH në këtë drejtim është ajo e reduktimit të numrit të drejtorive rajonale dhe rikonceptimi i kompetencave të tyre koordinuese.

### **FORCIMI I INTEGRITETIT POLICOR**

Në përgjithësi, një mjedis i shëndetshëm etik dhe me integritet karakterizohet nga vlerat morale dhe etike në organizatë si edhe nga një tërësi aktivitets për zbatimin e tyre. Ndërtimi i një kulture organizative që ndihmon në luftën kundër

korrupsionit kërkon ndërmarrjen e disa hapave në miratimin e rregullave dhe politikave antikorrupsion. Institucionet ligj zbatuese në vend gradualisht po kuptojnë se korrupsioni mund të adresohet përmes këtyre politikave në nivel njësie policore, të tilla si planet e integritetit.

Një Plan Integriteti synon të përmirësojë standardet e integritetit të njësisë policore përmes transparencës, llogaridhënies dhe masat kundër korrupsionit. Qëllimi i tij është ndërtimi i një rruge sistematike për identifikimin e proceseve dhe praktikave të cilat menaxhohen në mënyrë komplekse nga njësi policore dhe punonjësit e tij. Investimi gradual tek planet e integritetit në çdo njësi policore do të ndryshojë kulturën e menaxhimit të institucionit drejt një kulture menaxheriale të hapur dhe komunikuese brenda njësisë policore. Zgjidhja e problematikave të analizuar më sipër, nën këndvështrimin e alternativave të ofruara në këtë dokument apo edhe me alternativa të tjera është e rëndësishme të vijë në një kontekst gjithëpërfshirës.

Përgjatë tre dekadave të funksionimit të saj dhe reformave të PSH, ky institucion ka krijuar ndër të tjera edhe kapacitete njerëzore dhe ekspertizë e cila duhet të gjejë format dhe forumet e duhura për të kontribuar në vazhdimësi. Ndërkohë që politika do të mbetet aktori kryesor përgjegjës për ‘kodifikimin’ e masave reformuese, memoria institucionale e PSH, nevojat dhe kapacitetet e saj si edhe përballja me pritshmëritë dhe vlerësimin e publikut janë busulla më efektive për vendosjen në baza të qëndrueshme të reformës së PSH.

Analizimi i këtyre të dhënave dhe veçanërisht i sfidave të raportuara nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit, paraqiten në Planin e Veprimit (Blueprint) mbi forcimin e integritetit dhe llogaridhënies në PSH. Për të lexuar dokumentin e plotë mund të vizitoni faqen e IDM në [www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org)



**POLICI**

**BASHKI**

**PROKURORI**

**INTEGRITET**



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Kingdom of the Netherlands